



Prishtinë, 02.09.2021
Kodi i ZRRE-së: V_1369_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084),
- Dispozitat e Nenit 8 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081),
- Dispozitat e Nenit 7 par. 7.3.6 dhe 7.4 të Rregullës Nr. 03/2020 dhe Metodologjia për Përgatitjen e Bilanceve Elektrike dhe Termike,
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT Sh.A) të datës 25.06.2021 për derogim të dokumenteve Bilanci Afatgjatë i Energjisë Elektrike dhe Plani i Adekuacisë së Gjenerimit,

në seancën e mbajtur me datë 02.09.2021, nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** - kërkesa e KOSTT SH.A., për *Derogim të Bilancit Afatgjatë të Energjisë Elektrike dhe Planit të Adekuacisë së Gjenerimit.*

A R S Y E T I M

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 25.06.2021 ka pranuar kërkesën e KOSTT SH.A., për derogim për hartimin e dokumenteve Bilanci Afatgjatë i Energjisë Elektrike dhe Plani i Adekuacisë së Gjenerimit.

Sipas nenit 8 par. 9 të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081 është përcaktuar që bilanci afatgjatë i energjisë miratohet për një periudhë dhjetë (10) vjeçare, ndërsa azhurnimet e bilancit afatgjatë të energjisë miratohen çdo (2) vjet.

Poashtu, me Rregullën Nr. 03/2020 për përgatitjen e Bilanceve Elektrike dhe Termike të miratuara nga Bordi i ZRRE, është përcaktuar që duhet të përgatitet bilanci afatgjatë për energji elektrike për periudhën dhjetë (10) vjeçare dhe azhurnimet e tij duhet të miratohen çdo dy (2) vite, dhe Plani i adekuacisë (mjaftueshmërisë) së gjenerimit, i cili është i obligueshëm të hartohet sipas Kodit të



Rrjetit respektivisht neni 9 të Kodit të Planifikimit.

Prandaj, KOSTT SH.A. obligohet që deri me tridhjetë (30) nëntor 2021 të hartojë Bilancin Afatgjatë të Energjisë Elektrike dhe Planin e Adekuacisë së Gjenerimit sipas Strategjisë së Energjisë 2017-2026, e cila është aktualisht në fuqi.

Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së KOSTT për derogim të përgatitjes së Bilancit Afatgjatë të Energjisë Elektrike dhe Planit të Adekuacisë së Gjenerimit, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, palët e pakënaqura mund t'i drejtohen Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së,


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar


Lutfije Dervishi, anëtare


Gani Buqaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet palëve:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të ZRRE-së.